

VENDIM
Nr. 348, datë 13.4.2023

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KOALICIONIT “PARTIA DEMOKRATIKE–ALEANCA PËR NDRYSHIM”, QARKU TIRANË, Z. ASLLAN SHABAN DOGJANI

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1055/2 prot., datë 27.3.2023, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar, si pasojë e dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Belind Zamir Këlliçi, i zgjedhur në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, propozuar nga koalicioni “Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim”.

Koalicioni “Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim”, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e Komisionierit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 107, datë 2.3.2021.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë në datë 25.4.2021.

Komisionieri Shtetëror, nëpërmjet vendimit nr. 409, datë 23.6.2021, miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues, si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfituar mandate në bazë të numrit të votimeve parapëlqyese, qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.4.2021.

Sipas këtij vendimi, Koalicioni “Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim”, për zonën zgjedhore, qarku Tiranë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Sipas këtij vendimi rezulton se, kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 18 (tetëmbëdhjetë), z. Asllan Shaban Dogjani, i cili i përket Koalicionit Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim”.

Me shkresën nr. 2225 prot., datë 29.3.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidati për deputet, të listës shumëmemërore të koalicionit “Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, z. Asllan Shaban Dogjani, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, z. Asllan Shaban Dogjani, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 14 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nëpërmjet komunikimit elektronik ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, si dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Asllan Shaban Dogjani, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Asllan Shaban Dogjani.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Asllan Shaban Dogjani, ku konstatohet se kandidati, në bazë të vendimit nr. 317 datë 24.11.2004, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka deklaruar pushimin e gjykimit të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit akuzuar për veprën penale “Shpifjen dhe përhapjen e qëllimshme e thënieve dhe të çdo informacioni që dihet se janë të rreme”. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 97, datë 6.4.2005, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit. Konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Asllan Shaban Dogjani, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Belind Zamir Këlliçi, u përket kandidatit vijues në listën shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, i renditur me numër rendor 18 (tetëmbëdhjetë), z. Asllan Shaban Dogjani.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

VENDOS:

1. Dhënie e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, z. Asllan Shaban Dogjani.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONER SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Ilirjan Celibashi